

VENDIM
Nr.766, datë 28.5.2008

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË DREJTËSISË TË
OBJEKTIT “TOKË ARË”, NË PËRDORIM TË KOMUNËS CEPPO TË QARKUT
TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objekti “Tokë arë”, me numër pasurie 38, 39, 40, 606, 546, me sipërfaqe 77 901 (shtatëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e një) m², në pronësi shtetërore, në përdorim të komunës Cepo, në fshatin Kardhiq të qarkut të Gjirokastrës, në zonën kadastrale 2091, indeksi 145-D, të kalojë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë, për ndërtimin e mjediseve të paraburgimit dhe të burgut të Gjirokastrës.

2. Ky objekt, 6,08 (gjashtë presje zero tetë) ha, në zërin kadastral “Tokë bujqësore”, dhe 1,71 (një presje shtatëdhjetë e një) ha, në zërin kadastral “Tokë e pafrytshme”, të hiqet nga regjistrat kadastralë të SAMT-së, të qarkut të Gjirokastrës.

3. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UMI I PIKSIT

>>>>

PLAN RILEVIMI sh 1 / 1500
PRONESIA : KOMUNA CEPO GUIROKASTER
SIPERFAQE S = 77901.0 m2

S = 77901.0 m2

